



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:127890

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05680984

P.nr.145/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica, dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. Z. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1810/24 datë 02.05.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorit të Shtetit për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, më datë 03.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

B. Z., nga i ati Rr. e ëma F. e gjinisë Rr., i lindur më ..., me vendbanim në fshatin D. e P., i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal të letërnjoftimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

S E P S E

Me datë 13.04.2024, rreth orës 12:50, Policia e Kosovës, Stacioni Policor në P. ka marr informatën për një mosmarrëveshje në mes të familjes Z. ku prezent kanë qenë Rr. Z. dhe djali i tij B. F. dhe në anën tjetër Rr. H. dhe djali i tij M. H. e që lidhur me mosmarrëveshjet në mes tyre kanë pas edhe më parë raste të lajmëruara në polici dhe në ditën kritike familja H. duke punuar në murin e tyre e kishin vendosur një shkallë sipas Rr. Z. në pronën e tij i cili menjëherë kishte thirr policinë, me atë rast me të arritur policia i pandehuri B. F. në prezencën e policisë me qëllim të shkaktimit të ankthit dhe frikës ka kanosur seriozisht familjen H. duke thënë “do t’i dërgoj në vorr”, me ç’rast tek i dëmtuari Rr. H. ka shkaktuar ndjenjën e ankthit dhe frikës,-

-me këtë kryer veprën penale Kanosja, nga neni 181 par. 2, të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 181 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 359, 364, 449, 452, 462, 493 dhe 495 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë, në shumën prej **200€ (dyqind /euro)**, të cilin dënim i akuzuari është i detyruar ta paguajë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë Gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 të KPRK-së, t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një (1) ditë burgim, me njëzet (20) Euro të gjobës.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 Euro**, ndërsa në emër të kompensimit të viktimave të paguaj shumën prej **20 Euro**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. I dëmtuari Rr. H. nga fshati D. e P.-P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë me kërkesë për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor PP.II.nr.1810/24 datë 02.05.2024, kundër të akuzuarit B. Z. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Sipas nenit 493 par. 1 dhe 2 dhe 495 par 1 dhe 2 KPPRK-së, për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, dhe ka prova të besueshme se vërtetë i akuzuari e ka kryer veprën penale, në kërkesë të Prokuroritë të Shtetit në aktakuzë, gjykata mund ta aprovoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe të akuzuarit t'ia shqiptoj dënimin e propozuar si në kërkesë.

Sipas nenit 181 par. 2 të KPRK-së, për këtë veprë penale është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në një (1) vit. Po ashtu, Prokurori i Shtetit, kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, i ka bashkangjitur edhe prova të besueshme, nga të cilat prova rezulton se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale si në aktakuzë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas shqyrtimit paraprak të shkresave të lëndës dhe bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: Raporti fillestar i policisë me nr. 2024-AF-0318, të dt.13.04.2024, deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit Rr. H., e dhënë në polici më datë 13.04.2024, deklarata e dëshmitarit Rr. Z., e dhënë në polici me 13.04.2024, deklarata e dëshmitarit M. H. e dhënë në polici me datë 13.04.2024, deklarata e të pandehurit B. Z. e dhënë në polici më datë 13.04.2024, si dhe provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 495 të KPPRK-së dhe të akuzuarit ia shqiptoj dënimin me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, prandaj ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit-urdhrit ndëshkimor, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.145/24, dt. 03.05.2024.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij Aktgjykimi-Urdhri Ndëshkimor është i lejuar kundërshtimi brenda afatit prej 8 ditëve, nga dita e pranimit të njëjtit, drejtuar kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor merr formën e prerë.